



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 20/1 Prot.

Tiranë, më 31/5/2011

Lënda: Rekomandim për Shkollën e Mesme të Përgjithshme,
Gjimnazi “Qemal Stafa”.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Shkolla e Mesme e Përgjithshme, Gjimnazi “Qemal Stafa”**,

KONSTATOVA

Më datë 07/02/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **Shkolla e Mesme e Përgjithshme, Gjimnazi “Qemal Stafa”**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive të parashikuara në nenet 5,6,7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- A përpunohen e transmetohen të dhëna për qëllime statistikore, gazetarie e literature? Nëse zbatohen kriteret e parashikuara në nenet 10 e 11 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” .
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.

